



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ARBEN BROCI” SHKODËR

Nr. 36 prot.

Tiranë, më 07 . 02 .2025

Lënda: Njoftim për shpallje vendi vakant Përgjegjës i finances dhe administrimit

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; UDHËZIM Nr. 759, datë 30.9.2024 PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJEN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale “Arben Broci” Shkodër, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin

Përgjegjës i Sektorit të Finances dhe Administrimit

Kandidati aplikues për personel mbështetës në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë kriteret si më poshtë, si edhe kriteret e përgjithshme e të posaçme të përcaktuara në legjislacionin përkatës:

1. Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Kriteria të posaçme për përgjegjësin e sektorit të financës dhe administrimit:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master i shkencave” (ose të barasvlershme) në shkenca ekonomike;
- b) të ketë punuar të paktën 5 vjet përvojë pune në profesion;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në),
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhëne huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda afateve të aplikimit të përcaktuara në shpallje17.....02.. 2025

DREJTOR

Zamir Laçe